

NJOFTIM

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim çështja Nr.32 Regj. Themeltar, Datë 12.06.2023 Regjistrimi, me:

PADITËS: Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

I PADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – KQZ.

OBJEKTI: Ndryshimin e Vendimit nr.177, datë 08.06.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur: Prishjen e Vendimit të KSHZ nr.539, datë 20.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në Zonën Zgjedhore Bashkia Elbasan, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023”, duke vendosur:

- (i) Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Bashkia Elbasan; dhe
- (ii) Përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë si dhe të Këshillit Bashkiak Elbasan me anë të votimit tradicional me fletë votimi fizike.

Më datë **13.06.2023** u hodh shorti publik për përcaktimin e përbërjes së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe, sipas tij, trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

- 1. Blerona Hasa (Relatore);**
- 2. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 3. Alma Kolgjoka (Anëtare);**
- 4. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 5. Emona Muçi (Anëtare).**

Me Urdhër datë 16.06.2023 “Për caktimin e seancës gjyqësore” të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor është caktuar data **20.06.2023, ora 09:30**, për zhvillimin e seancës gjyqësore.

Lidhur me ambientin e zhvillimit të seancës gjyqësore, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor caktoi **Gjykatën Administrative të Apelit, në adresën Rr.“Ismail Qemali”, Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë**, në kushtet kur prej njoftimit të datës 14.06.2023, në grupin e gazetarëve në aplikacionin WhatsApp, nuk pati asnjë konfirmim për pjesëmarrje në seancë, çka do të diktonte zhvillimin e seancës në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Tiranë, më 19.06.2023.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë